


### **Aktivitetet e parapara të QKKDM-së në Suedi në bazë të PVP-së - 2015**

Më 17 janar 2015, Qendra Kulturore e Kosovës në Halmstad, në kuadër të aktiviteteve “ Flaka e janarit 2015”, do të organizojë një akademi përkujtimore për tre veprimtarët e njohur të çështjes sonë kombëtare: Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Në këtë manifestim do të marrin pjesë familjarë të këtyre veprimtarëve dhe përfaqësues nga institucionet e Kosovës.

Pjesëmarrja juaj në këtë manifestim historik-kulturor do ta bëjë më të madhërishëm atë dhe do të nderojë veprimtarinë e këtyre veprimtarëve të çështjes sonë kombëtare.

Akademia do të mbahet më 17 janar 2015, në lokalet e Qendrës Kulturore të Kosovës në Halmstad, Smedvägen 27, 30266, Trönninge – Halmstad, në orën 13:00.



### **Ta festojmë së bashku 7-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës**

Ftohen bashkatdhetarët dhe të gjitha shoqatat në Suedi të marrin pjesë në shënimin e përvjetorit të 7-të të Pavarësisë së Kosovës.

Asociacionet kulturore -arsimore në Suedi, në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës - Qendrën Kulturore të Kosovës për Diasporë dhe Mërgatë, organizojnë manifestimin kulturor me rastin e 7-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Manifestimi mbahet më 21 shkurt 2014, në lokalet e Qendrës Kulturore të Kosovës në Halmstad.

Në këtë manifestim do të ketë edhe një diskutim të nivelit akademik lidhur me rëndësinë e 17 shkurtit.

Planifikohet të marrin pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore të Kosovës, përfaqësues nga Ambasada e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës , si dhe mysafirë e veprimtarë të ndryshëm nga diaspora që kanë kontribuar për Pavarësinë e Kosovës.



### **Në jubileun e 30-të të shkollës shqipe në Halmstad të Suedisë**

Me rastin e shënimit të këtij përvjetori të rëndësishëm, Qendra Kulturore e Kosovës për Diasporë dhe Mërgatë dhe Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me shkollën shqipe në Halmstad dhe asociacionet e tjera kulturore-arsimore në Suedi, mbajtën një manifestim kulturor kushtuar jubileut të 30-të të shkollës shqipe në Halmstad të Suedisë. Këtij manifestimi ia shtuan madhështinë pjesëmarrja e delegacionit të komunës së Malishevës, me kryetar z. Ragip Begaj,

dhe e kryetarit të komunës së Halmstadit, z. Karl Fredrik Graff. Nderoi me pjesëmarrje edhe ish zv. ministri i Kulturës në Qeverinë e Kosovës, dr. Hajdin Abazi. Shumë nxënës, mësues e prindër, me pjesëmarrjen e tyre bënë të veçantë këtë mbledhje kulturore. Pata kënaqësinë t'î dorëzoi mirënjohjen e Ministrisë së Diasporës mësuesit nismëtar të kësaj shkolle që në këtë mars mbushi 30 vjet, z. Nuhi Mazreku.

